



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

**NJOFTIM PËR MEDIA**

Ditën e enjte, në datën 11 korrik 2019, u zhvillua mbledhja e radhës së Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

<b>Gentian</b>	<b>SALA</b>	<b>Kryetar</b>
<b>Sami</b>	<b>NEZAJ</b>	<b>Zëvendëskryetar</b>
<b>Agron</b>	<b>GJEKMARKAJ</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Gledis</b>	<b>GJIPALI</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Piro</b>	<b>MISHA</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Suela</b>	<b>MUSTA</b>	<b>Anëtar</b>

AMA, pasi shqyrtoi çështjet e rendit të ditës, vendosi:

1. “Pranimin e kërkesës për përfshirjen në paketën programore të RTSH-së, të programit “RTSH Plus” në vend të programit “RTSH Jetë” dhe rrëzimin e kërkesës për përfshirjen në paketën programore të “RTSH Agro” në vend të “RTSH Fëmijë”. **(Vendimi nr. 96, datë 11.07.2019)**
2. “Heqjen e së drejtës së përdorimit të frekuencës 7284 kHz (AM), operatorit publik, Radio Televizioni Shqiptar, për transmetimet me valë të shkurtra”. **(Vendimi nr. 97, datë 11.07.2019)**
3. “Rinovimin e licencës së shoqërisë “RTV-ADRIAMED” sh.p.k., për subjektin audio privat “Radio Durrësi” për një periudhë 5 vjeçare”. **(Vendimi nr. 98, datë 11.07.2019)**
4. “Zgjerimin e zonës së ofrimit të shërbimit të shoqatës “Radio Maria”, licencuar për subjektin audio të komunitetit “Radio Maria” për të mbuluar me sinjal audio “Bashkitë Elbasan, Cerrik, Belsh dhe Vlorë”. **(Vendimi nr. 99, datë 11.07.2019)**
5. “Rinovimin e autorizimit të subjektit person fizik Rahman Mekollari, për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv Kabllor Kristal” për një periudhë 5 vjeçare.” **(Vendimi nr. 100, datë 11.07.2019)**
6. “Rinovimin e autorizimit të subjektit person fizik Agron Beqiri, për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv Kabllor Amaregi” për një periudhë 5 vjeçare.” **(Vendimi nr. 101, datë 11.07.2019)**
7. “Rinovimin e autorizimit për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv Kabllor Vaqarr” dhe zgjerimin e zonës së ofrimit të shërbimit në “Njësitë administrative Ndroq dhe Rrashbull” për një periudhë 5 vjeçare”. **(Vendimi nr. 102, datë 11.07.2019)**
8. “Konstatimin e pavlefshmërisë së autorizimit, lëshuar për subjektin person fizik Fatjon Latifi, për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjetin kabllor “Tv Kabllor ENT” **(Vendimi nr. 103, datë 11.07.2019)**

9. “Mosrinovimin e autorizimit të subjektit person fizik Altin Sharka, për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv Kabllor Hysgjokaj”. **(Vendimi nr. 104, datë 11.07.2019)**
10. “Rrëzimin e aplikimit të shoqërisë “Klobes” sh.p.k., për marrje autorizimi për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Klobes”. **(Vendimi nr. 105, datë 11.07.2019)**
11. “Pranimin e kërkesës së shoqërisë “Media Vizion” sh.a., licencuar për transmetime numerike private kombëtare për dhënien e të drejtës së përdorimit të kanalit 53 UHF, në allotmentin e Vlorës”. **(Vendimi nr. 106, datë 11.07.2019)**
12. “Pranimin e kërkesës së shoqërisë “Tring TV” sh.a., për korrigjimin e gabimit material në vendimin nr. 114, datë 12.07.2017 të AMA-s “Për rrëzimin e ankimit administrativ dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 65, datë 01.12.2016 për dënimin me gjobë, në masën 1.000.000 (një milion) lekë, ndaj shoqërisë “Tring TV” sh.a., të autorizuar për subjektin OSHMA “Tring TV”. **(Vendimi nr. 107, datë 11.07.2019)**
13. “Pranimin e ankimit administrativ të shoqërisë “3DS&AF Entertainment” sh.p.k., dhe shfuqizimin e vendimit, gjobë nr. 13, datë 06.05.2019, të vendosur ndaj subjektit audioviziv “Tv TNT” dhe subjektit audio “Best Radio”. **(Vendimi nr. 108, datë 11.07.2019)**
14. “Refuzimin e ankimit administrativ të shoqërisë “Multiscreen” sh.p.k., dhe lënien në fuqi të vendimit, gjobë nr. 66, datë 17.04.2019, në masën 200,000 lekë, të vendosur ndaj subjektit audioviziv “Report Tv”. **(Vendimi nr. 109, datë 11.07.2019)**
15. Pranimin e pjesshëm të ankimit administrativ të shoqërisë “Ora” sh.a., dhe ndryshimin e masës së sanksionit me gjobë nr. 65, datë 17.04.2019, nga 400,000 lekë në 200,000 lekë, të vendosur ndaj subjektit audioviziv “Ora News”. **(Vendimi nr. 110, datë 11.07.2019)**
16. Refuzimin e ankimit administrativ të subjektit person fizik Edi Tanushi dhe lënien në fuqi të vendimit, gjobë nr. 09, datë 24.04.2019, në masën 1,000,000 lekë, të vendosur ndaj subjektit “Tv kabllor Danja”. **(Vendimi nr. 111, datë 11.07.2019)**
17. Refuzimin e ankimit administrativ të subjektit person fizik Sevi Mediu dhe lënien në fuqi të vendimit, gjobë nr. 07 datë 17.04.2019, në masën 1,000,000 lekë, të vendosur ndaj subjektit “Tv kabllor Anfab.” **(Vendimi nr. 112, datë 11.07.2019)**
18. Refuzimin e ankimit administrativ të subjektit person fizik Sevi Mediu dhe lënien në fuqi të vendimit, gjobë nr. 08 datë 19.04.2019, në masën 1,000,000 lekë, të vendosur ndaj subjektit “Tv kabllor Anfab.” **(Vendimi nr. 113, datë 11.07.2019)**
19. Refuzimin e ankimit administrativ të subjektit person fizik Altin Sharka dhe lënien në fuqi të vendimit, gjobë nr. 04, datë 15.04.2019, në masën 2,000,000 lekë, të vendosur ndaj subjektit “Tv kabllor Hysgjokaj”. **(Vendimi nr. 114, datë 11.07.2019)**
20. Refuzimin e ankimit administrativ të subjektit person fizik Gëzim Cake dhe lënien në fuqi të vendimit, gjobë nr. 10, datë 25.04.2019, në masën 1,000,000 lekë, të vendosur ndaj subjektit “Tv Kabllor Zargoçan.” **(Vendimi nr. 115, datë 11.07.2019)**
21. Refuzimin e ankimit administrativ të subjektit person fizik Guri Meko dhe lënien në fuqi të vendimit, gjobë nr. 11, datë 25.04.2019, në masën 1,000,000 lekë, të vendosur ndaj subjektit “Tv Kabllor Aral.” **(Vendimi nr. 116, datë 11.07.2019)**

**Tiranë, 11 korrik 2019**

**AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE**

